



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0134**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-kryetare, Isa Hasani-Referues dhe Vedat Poterqoi-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “RSM Company” SH.P.K e parashtruar kundër Vendimin për dhënie të kontratës nga Kuvendi Komunal Gjilan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore ne komunën e Gjilanit” me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1 me 16.04.2024, mori:

## **Vendim**

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE RSM-Company SH.P.K e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 13.02.2024, me numër protokollit 134/2024, kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore ne komunën e Gjilanit” me nr. të prokurimit 651-22-10313-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- KK GJILAN” kurse vendimi i AK mbetet ne fuqi.

2. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet pjesërisht, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 30 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 29.09.2022, KK GJILAN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore ne komunën e Gjilanit” me nr. Të prokurimit: 651-22-10313-2-1-1. Ndërkaq me datën 06.02.2024 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK me te cilin ka shpërblyer me

kontratë GOE “AVAG GROUP SH.P. K & SINJAL SH.P. K”

(OE) “RSM Company” SH.P.K me datën 07.02.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK-së te datës 06.02.2024. AK me datën 12.02.2024 e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “RSM Company” SH.P.K me 13.02.2024, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 134/24, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Mbi fazën e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Bazuar në lartë cekurat, OSHP ka angazhuar ekspertin në pajtim me nenin 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Me datë 14.02.2024, është autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. prtokoll 2024/0134, ndërsa me datë 04.03.2024 ka dorëzuar raportin e toj/saj me rekomandimet si në vijim:

a. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

OSHP, ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës (përmes postës elektronike) me c’rast AK nuk pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërsa ankuesi është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe rekomandimet të cilat ekspertiza e cituar i përmban.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

AK- Kuvendi Komunal Gjilan, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe paisjeve rrugore ne komunën e Gjilanit, me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1”, procedurë e hapur, lloji i kontratës: Shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 340,000.00€.

Autoriteti Kontraktues sipas vendimit të PSH Nr. 2023/0549 të datës 18.12.2023, me datë 06.02.2024 ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së. Me 07.02.2024, OE-RSM COMPANY SHPK, kundër vendimit të AK-së ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim. AK me 12.02.2024, ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me 13.02.2024, OE-RSM COMPANY SHPK, ka parashtruar ankesë në OSHP-së.

Bazuar në pretendimet ankimore në raport me natyrën e çështjes në rastin konkret dhe kriteret e publikuar sipas dosjes së tenderit në rastin konkret, Paneli e ka konvokuar seancën dëgjimore me palë (AK dhe OE) e cila është mbajtur me datën 25.03.2024, sikurse parashihet me paragrafin 2 të nenit 24 të Rregullores për punën e OSHP, duke e konsideruar këtë paraprakisht të nevojshme me qëllim të vlerësimit të drejtë të çështjes. Paraprakisht Paneli konstatoi se nuk ka elemente për ekzistimin e konfliktit eventual të interesit, sikurse përkufizohet në kuptim të paragrafit 1.75, të neni 4, të LPP, lidhur me dispozitën e nenit 11 të Rregullores së cituar, kurse pohimet e palëve, shpjegimet e ekspertit dhe provat e administruara, janë evidentuar në procesverbalin e kësaj seance, të cilat në këtë rast për nevojat e këtij vendimi prezantohen (shkurtimisht) sikurse vijon:

- Seanca dëgjimore –

Pretendimet e OE "RSM Company" SH.P.K. gjatë seancës së shqyrtimit kryesor dhe në parashtrësene tij/saj ka deklaruar si vijon:

Në dokumentacionin e tenderit, në pikat 9.1 dhe 9.2, është kërkuar që operatori ekonomik të ofrojë dëshmi për kontrata të suksesshme të ngjashme në 3 vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, me një vlerë jo më pak se 450,000,00 €. Kompania jonë ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar, edhe pas kërkesave për sqarime dhe dokumente shtesë nga Autoriteti Kontraktues (AK) dhe Organit Shqyrtues i Prokurimit (OSHP). Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ka konfirmuar për OSHP se kontrata e cila ishte kontestuese për AK K e Gjilanit, ka qenë kontratë publike kornizë për tri (3) vite citur sikurse në vijim: “Lidhur me kontratën “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës për Lot V” e cila është lidhur datë 28.06.2018 me nr.44/2018 në mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Operatorit Ekonomik „RSM Company” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ju informojmë se: ...Kontrata me nr.44/2018 ka qenë kontratë kornizë 3 vjeçare (36 muaj), ka përfunduar me datë 23.06.2021. Kontrata është lidhë me çmim njësi dhe është: 4.37 €, apo total për vit (209,865.01 euro) ± 30%, ndërsa vlera e punëve të realizuar për periudhën tre vite (36 muaj) është 2018/2019 (208,838.17 € në bazë të raportit përfundimtar të punimeve të datës 18.06.2019 dhe referencës me nr.5607 e datës 28.07.2020) 2019/2020 (205,950.59 € në bazë të raportit përfundimtar të punimeve të datës 05.05.2020 dhe referencës me nr.5606 e datës 28.07.2020) 2020/2021 (250,964.53 € në bazë të raportit përfundimtar të punimeve të datës 23.06.2021 dhe referencës me nr.3621 e datës 12.04.2023). ankuesi pohon se raportet përfundimtare të punëve të kryera janë bërë në përfundim të secilit vit veç e veç dhe janë të shoqëruara me referencat përkatëse. Megjithatë, në vendimin e AK-së të datës 06.02.2024, kompania jonë është informuar serish se është eliminuar për shkak të mosplotësimit të këtij kriteri, ndonëse realisht kjo çështje është në kundërshtim me gjetjet e panelit të OSHP sipas vendimit të tyre të datës 18.12.2023 dhe nr. protokolli 549/2023. Vlen të theksohet se në vendim paraprak, OSHP ka rekomanduar që AK të jetë i kujdesshëm gjatë procedurave të prokurimit publik dhe të respektojë vendimin e tyre dhe se parimisht për OSHP kontrata kontestuese duhet të pranohet. Megjithatë, AK nuk ka marrë parasysh vendimin e OSHP-së dhe po tenton të eliminojë kompaninë tone duke shkelur dispozitat e Ligjit të Prokurimit [LPP] dhe legjislacionin sekondar të prokurimit publik. OE "RSM Company" SH.P.K. thkeson faktin se kontrata në fjalë, për të cilën është përjashtuar nga Komuna e Gjilanit, është një kontratë kornize me një afat prej 36 muajsh, e nënshkruar qysh në vitin 2018. Kurse sipas legjislacionit mbi prokurimin publik, këto kontrata kornize përfundojnë në dy raste: 1) kur është arritur shuma e parashikuar për këtë kontratë (buxheti i planifikuar) dhe 2) kur kanë kaluar

36 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, dhe jo me lëshimin e një referenca. Kurse referenca në fjalë tregon qartësisht se punimet në projektin e diskutuar janë përfunduar më datën 23 qershor 2021, duke përfshirë një situatë të lirimit të ruajtjes (10%), e cila është njohur nga Ministria e Infrastrukturës si një situatë përfundimtare e punimeve në atë projekt. Kjo do të thotë se kontrata është konsideruar e përfunduar po me atë datë dhe kjo gjithashtu është konfirmuar edhe në raportin përfundimtar të punimeve. Për sa i përket shembullit të cilit i referohet AK për një projekt të mirëmbajtjes së rrugëve kombëtare [natyrë tjetër të prokurimit] duke prezantuar si prove një raport për pranim teknik, duam të bëjmë të qartë që Ministria e Infrastrukturës, nuk aplikon gjithmonë pranimin teknik përfundimtar, sidomos për projektet e sinjalizimit horizontal dhe vertikal kurse kjo mund të konfirmohet nga vetë ministria. Përfundimisht apelojmë te Paneli Shqyrtues që të rishqyrtojë shkëljet e evidentuara me vendimin e mëparshëm dhe të ndalojë dëmtimin e kompanisë tonë. Kjo çështje duhet të trajtohet si një çështje e përfunduar dhe Paneli duhet të marrë masa ligjore ndaj zyrtarëve të autoritetit kontraktues për mosrespektimin e vendimit të OSHP-së në këtë çështje. RSM Company SH.P.K. vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e Nenit 61, 7, 59 dhe 105 të kompetencave të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Për këtë arsye, ata propozojnë Panelit Shqyrtues që të miratojë ankesën si të bazuar dhe të detyrojë AK-në të veproj në përputhje me vendimin e OSHP-së, sqarimet e Ministrisë së Infrastrukturës, dhe në rezultat të rekomandohet si fituese kompania "RSM Company" SH.P.K. Kjo do të ndalonte dëmtimin e kompanisë "RSM Company" SH.P.K. dhe gjithashtu dëmtimin e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritet Kontraktues [AK], gjatë seancës kryesore identifikon se pretendimi kryesor lidhur me eliminimin e tij qendron dhe asesi nuk është në kundërshtim me vendimin e OSHP-së 549/2023. Ata argumentojnë se dëshmitë paraqitura gjatë ofertimit, sqarimit të tenderit dhe në procedure pranë OSHP, vertetohet pa medyshtje se ankuesi nuk ka ofertuar në përputhje me kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit. AK ka vlerësuar faktet dhe provat e prezantuara ankuesi dhe konform vendimit të OSHP-së kemi kërkuar dëshmi shtesë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Bazuar në këtë, MMPHI ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm që përfshinte raporte periodike të punëve të kryera nga OE ankues, si dhe dokumente shtesë që nuk ishin prezantuar më parë. AK bazuar në raportin e komisionit profesional të vlerësimit ka identifikuar mungesën e dëshmimeve teknike për të plotësuar kriteret kualifikuese të dosjes së tenderit për OE ankuesin. Duke theksuar se edhe pse janë prezantuar raporte periodike nga menaxheri i kontratës për disa nga referencat, mungesa e një procesverbal/certifikate të pranimit teknik të punëve të kryera ka çuar në mospërmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit. Kjo për faktin se dëshmitë e dorëzuara nga ankuesi gjatë ofertimit dhe sqarimit të tenderëve si dhe dëshmitë shtesë të prezantuara nga ana e MMPHI siç u shpjeguan më sipër, fare qartë vëretojnë faktin se ankuesi nuk e ka plotësuar kërkesën e lartcekur të kapacitetit teknik dhe profesional të nenit 9.1 & 9.2 të FTD-së sepse nuk ka prezantuar procesverbal/certifikatë të pranimit të përkohshëm teknik të punëve të kryera për kontratën "Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës - Lot 5" me numër të prokurimit MI-17-061-511 të lëshuar nga Komisioni për Pranim Teknik të Punëve, ashtu siç përcaktohet me nenin 33 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës me nr. 44/2018 si dhe siç përcaktohet në paragrafin 4.2 të nenit 69 të LPP-së dhe Udhëzimin Administrativ për Mbikëqyrjen, Pranimin Teknik e Punëve të Kryera në Infrastrukturën/Objektet Rrugore, i cili është nxjerrë nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës. Por Ankuesi kaprezantuar raporte të punëve periodike nga menaxheri i kontratës dhe jo nga Komisioni si do duhej, për dy nga tri referencat e prezantuara lidhur me këtë kontratë. Këtë konstatim faktik se projekti i lartcekur nuk ka pasur pranim teknik me rastin procesit të ofertimit dhe hapjes së ofertave përfshirë edhe procesin e vlerësimit, e vërteton edhe vet raporti periodik i punëve të realizuara i

dt. 23.06. 2021 (pa vulë dhe protokoll të MMPHI-së) i dorëzuar me rastin e ofertimit nga ana e juaj i cili referohet punëve të realizuara për një vit kalendarik 12 muaj (2020-2021) në shumën 250,964.536, lidhur me referencën periodike të dt. 12.04.2023 me nr. prot. 3621, si e tillë nuk ka ekzistuar para afatit për dorëzim të ofertave ashtu siç e vërteton këtë vula dhe data e protokollit të MMPHI, pra e njëjta është dorëzuar nga ana e OE ankues në AK me datën 10.07.2023, në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së i cili ka përcaktuar se “Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Kruse raporti tjetër periodik i dt. 05.05.2020 (pa vulë dhe protokoll të MMPHI-së) i cili nuk ka ekzistuar/paraqitur asnjëherë deri me datën 27.12.2023 dhe po ashtu nuk mund të vërtetohet ekzistenca e tij në mënyrë objektive para hapjes së ofertave, i njëjti i referohet punëve të realizuara për një vit kalendarik 12 muaj (2019-2020) në shumën 205,950.596 lidhur me referencën e bashkëngjitur me nr prot. 5606 e dt. 28.07.2020. Konkretisht neni 5 (Dëshmitë mbi Kualitetin e Punëve të Realizuara) i këtyre dy raporteve ku thuhet “nuk janë bërë ekzaminimet laboratorike pavarësisht se sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve është lëmi specifike pasi që Ministria e Infrastrukturës nuk ka të lidhur kontratë për realizimin e këtyre testeve”. Fakt ky i cili është pranuar edhe nga ana e juaj në ankesën të cilën e keni parashtruar në OSHP me numër të protokollit 2023/0549 e dt. 07.08.2023, duke theksuar se, cituar: “Kjo kontrate ne fjale dhe asnjë nga kontratat për lotet tjera qe kane patur kompanitë tjera nuk kane pranim teknik përfundimtar. Për këtë mund te vërtetoni tek Ministria e Infrastrukturës”. Prandaj bazuar në të lartcekurat shihet qartë tendenca dhe përpjekjet e OE ankues që të bllokohet dhe pengohet me ankesa realizimi i këtij projekti pa pasur asnjë shkelje ligjore dhe asnjë dëm të pësuar për OE ankues, pavarësisht se i njëjti tenton të krijojë përshtypjen qe diçka e paligjshme ka ndodhur në dëm të OE ankues pavarësisht se supozojmë se OE ankues është i vetëdijshëm/ose e kundërta se realiteti është krejt ndryshe. Bazuar në këto konstatime, AK ka vënë në dyshim aftësinë teknike dhe profesionale të OE ankuesit për të përmbushur kriteret kualifikuese të dosjes së tenderit. Për pasojë, vendimi për eliminimin e ofertës së OE ankuesit dhe dhënia e kontratës për OE "Avag Group & Sinjali SH.P.K" është vlerësuar si i ligjshëm dhe i bazuar në faktet dhe ligjin përkatës. AK konsideron se pretendimet e OE ankuesit nuk janë të mbështetura në fakte ose prova të mjaftueshme dhe, si rrjedhojë, vendimi për eliminimin e ofertës së tyre është në pajtim me ligjin dhe parimet themelore të prokurimit publik.

Eksperti Shqyrtues gjatë seancës dëgjimore sqaron cituar: Sa i përket çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 1 a) AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues ka dhënë arsyetimet e njëjta si me pare, gjithnjë duke marrë për bazë edhe ne përgjigjen e dhënë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me date 27.12.2023. Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues OE-RSM Company SH.P.K, të paraqitura në ankesën 2024/0134 për këtë aktivitet të prokurimit, Eksperti shqyrtues sqaron se këto pretendime ankimore nuk i ka shqyrtuar, për faktin se, të njëjtat janë shqyrtuar në lëndën me Nr. 2023/0549, andaj duke u bazuar në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 16 të Rregullores së Punës të OSHP-së, duke qenë se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar më parë nga Paneli Shqyrtues, kjo çështje trajtohet si çështje e gjykuar “res judicata”, rrjedhimisht lidhur me këtë çështje, PSH ka nxjerrë Vendim me date 18.12.2023, përkatësisht Vendimi me Nr. 2023/0549.Lidhur me vendimin e lartë cekur, gjetjet e Panelit Shqyrtues janë si në vijim: “...Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP lidhur me nenin 40 të RRPP. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankues “RSM Company” Sh.P.K., fillimisht duhet sqaruar se me datë 13.12.2023, AK ka konfirmuar për OSHP se kontrata për të cilën po bëhet fjalë ka qenë kontratë publike kornizë për

tri (3) vite me përgjigjet si në vijim: lidhur me kontratën “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës për Lot V’ e cila është lidhur datë 28.06.2018 me nr.44/2018 në mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Operatorit Ekonomik „RSM Company” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ju informojmë se: ...Kontrata me nr.44/2018 ka qenë kontratë kornizë 3 vjeçare (36 muaj), ka përfunduar me datë 23.06.2021. Kontrata është lidhë me çmim njësi dhe është: 4.37 €, apo total për vit (209,865.01 euro) ± 30%, ndërsa vlera e punëve të realizuar për periudhën tre vite (36 muaj) është: 2018/2019 (208,838.17 € në bazë të raportit përfundimtar të punimeve të datës 18.06.2019 dhe dhe referencës me nr.5607 e datës 28.07.2020) 2019/2020 (205,950.59 € në bazë të raportit përfundimtar të punimeve të datës 05.05.2020 dhe referencës me nr.5606 e datës 8 28.07.2020) 2020/2021 (250,964.53 € në bazë të raportit përfundimtar të punimeve të datës 23.06.2021 dhe referencës me nr.3621 e datës 12.04.2023). Raportet përfundimtare të punëve të kryera të cilët janë bërë në përfundim të secilit vit veç e veç të shoqëruara me referencat përkatëse... Njëherit, Eksperti Shqyrtues sqaron se, përmes këtij vendimi të OSHP-së, “...Paneli Shqyrtues parimisht konsideron se kontrata publike kornizë për të cilën bëhet fjalë në pretendimin ankimor është në përputhje me kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit...megjithatë, Autoritetit Kontraktues KK Gjilan, i epet të drejtë që gjatë procedurës së rivlerësimit ti verifikoj të gjitha këto raporte teknike dhe referenca të dorëzuara si dëshmi edhe nga AK Ministria e Infrastrukturës. Eksperti shqyrtues pas vendimit të OSHP-së Nr. 2023/0549 të datës 18.12.2023, paraqet ecurinë lidhur me këtë lëndë: Bazuar në shkresat e lëndës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Eksperti shqyrtues sqaron se, sipas vendimit të lartë cekur të OSHP-së, Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL GJILAN, ka kthyer lëndën në Rivlerësim, me ç ‘rast AK KK Gjilan, përmes adresës elektronike me date 26.12.2023, ka kërkuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, “Raportin/Certifikata e pranimit të përkohshëm të përfundimit të punimeve të hartuara nga komisioni për pranim teknik në baze të nenit 33 të kontratës Nr. Prot.6223 e datës 23.06.2018 të lidhur me OE “RSM Company” .... Ndërsa, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka kthyer përgjigje me date 27.12.2023, lidhur me kontratën “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale të Kosovës Lot 5 “me nr. të Prokurimit MI 17 0061 511. Provë: Bazuar nga dokumentet e paraqitura nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përkatësisht në përgjigjen e dhen me datën 27.12.2023 lidhur me kontratën “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugë nacionale të Kosovës Lot 5” me nr. të prokurimit MI 17-0061-511 përveç që janë paraqitur raportet dhe referencat periodike sipas realizimit për vitet përkatës, shihet se nuk ka prezantuar si dëshmi Raportin/Certifikatën apo Procesverbalin e pranimit teknik të punëve të kryera mbi të dhënat e përgjithshme të kontratës në fjalë. Vlen të ceket se, gjatë shqyrtimit dhe administrimit të provave shkresore lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, edhe pas rivlerësimit të tenderit si rezultat i vendimit të OSHP-së nr.2023/0549 të datës 18.12.2023, të njëjtat dëshmi janë prezantuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ashtu siç janë prezantuar dhe janë shqyrtuar edhe me herët në këtë vendim.Eksperti shqyrtues sqaron se, KK Gjilan, në shkresat e lendes ka bashkangjitur edhe një dokument të siguruar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si provë në aspektin krahasueses, ku thekson se duke qenë raportet dhe referencat e prezantuara (gjatë dhe pas ofertimit) nga ana e OE ankues “Rsm Company” Sh.p.k., janë raporte/referenca periodike që si të tilla nuk përcaktojnë përfundimin dhe pranimit teknik të punimeve ashtu siç kërkohet me raport/procesverbal të pranimit teknik të punëve të realizuara në bazë të nenit 32 dhe 33 të kontratës nr.44/2018 që i referohen dhe në pajtueshmëri me paragrafin 4.2 të nenit 69 të LPP-së, për t’a kundër argumentuar “pohimin e pabazë të OE ankues, si dëshmi ka dërguar edhe një Procesverbal të Pranimit Teknik të punëve të kryera për një projekt të caktuar (shërbim) të lëshuar nga e njëjta ministri, përkatësisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe

Infrastrukturës”. Provë: Eksperti shqyrtues lidhur me këtë qeshtje sqaron se, duke marr parasysh shkresat e lëndës të paraqitura në këtë raport, në kuptim të dëshmisë që një OE ka kryer me sukses një kontratë, kjo mund të dëshmohet në raportin përfundimtar të kryerjes së punëve apo me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve e cila si dëshmi përmendet në nenin 69 të LPP-së. Një Certifikatë e tillë kërkohet të lëshohet OE-së nga AK edhe sipas Kushteve të Kontratës. Pra, realizimin e një kontratë e dëshmon Raporti përfundimtar të kryerjes së punëve apo me Certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve, ashtu siç përmendet në nenin 69 të LPP-së. Ndërsa, referenca lëshohet rëndom nga AK sipas kërkesës së OE pas përfundimit të kontratës, gjithnjë në bazë të raportit përfundimtar të kryerjes së punëve.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP.

Sipas vendimit paraprak paneli shqyrtues parimisht kishte theksuar se “kontrata publike kornizë” e prezantuar nga OE dhe e kontestuar nga AK, ishte në përputhje me kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit, megjithatë sa i perket dëshmise të ofruara/prezantuara nga OE në ofertën e tij, kishte udhëzuar AK që gjatë procedurës së rivlerësimit, nëse eventualisht ka dilema për rregullsinë nga aspekti teknik/administrativ, ka të drejtë të verifikoj të gjitha raportet teknike dhe referenca pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës [MMPH] si dhënëse e kësaj kontrate kontestuese. AK gjatë procedurës së rivlerësimit bazuar në raportin nga komisioni profesional vërehet se ka kërkuar sqarime shtese nga Ministria përkatëse, dhe se sipas saj pas pranimit të dëshmise relevante ka rezultuar se OE ankues është i papërgjegjshëm sepse ka deshtuar të sigurojë dëshmine perktase të kërkuar në DT siç është kërkuar “certificate apo pranim teknik të punëve të kryera”.

AK, mes tjerash ka sqaruar se OE nuk ka prezantuar procesverbal/certifikatë të pranimit teknik të punëve të kryera për kontratën “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës - Lot 5” me numër të prokurimit MI-17-061-511 të lëshuar nga Komisioni për Pranim Teknik të Punëve, ashtu siç përcaktohet me nenin 33 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës me nr. 44/2018 si dhe siç përcaktohet në paragrafin 4.2 të nenit 69 të LPP-së dhe Udhëzimin Administrativ për Mbikëqyrjen, Pranimit Teknik e Punëve të Kryera në Infrastrukturën/Objektet Rrugore i cili është nxjerrë nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës. Por

sipas AK janë prezantuar vetëm raporte të punëve periodike nga menaxheri i kontratës për dy nga tri referencat e prezantuara lidhur me këtë kontratë. Këtë konstatim faktik se projekti i lartcekur nuk ka pasur pranim teknik me rastin procesit të ofertimit dhe hapjes së ofertave përfshirë edhe procesin e vlerësimit, e vërteton sipas AK edhe vet raporti periodik i punëve të realizuara i dt. 23.06.2021 ( i cili figuron pa vulë dhe protokoll të MMPHI-së) i dorëzuar me rastin e ofertimit nga ankuesi i cili i referohet punëve të realizuara për një vit kalendarik 12 muaj (2020-2021) në shumën 250,964.536, kurse lidhur me referencën periodike e cila mbanë datën e lëshimit 12.04.2023 Nr.protokolli 3621, si e till nuk ka ekzistuar para afatit për dorëzim të ofertave dhe nuk është prezantuar me kohë në ofertën e tij, por e njëjta është dorëzuar në AK me datën 10.07.2023 i cili veprim bie ndesh me nenin 72 të LPP-së. Po ashtu referuar konkretisht neni 5 (Dëshmitë mbi Kualitetin e Punëve të Realizuara) i këtyre dy raporteve thuhet mes tjerash se “nuk janë bërë ekzaminimet laboratorike pavarësisht se sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve është lëmi specifice, pasi që Ministria e Infrastrukturës nuk ka të lidhur kontratë për realizimin e këtyre testeve”. Fakt ky i cili ishte pranuar nga ankuesi edhe në ankesën e parashtuar në OSHP me numër të protokollit 2023/0549 e dt. 07.08.2023, cituar: “Kjo kontrate ne fjale dhe asnjë nga kontratat për lotet tjera qe kane patur kompanitë tjera nuk kane pranim teknik përfundimtar.

Eksperti ka pohuar se kjo është duhet konsideruar si çështje e gjykuar duke thekuar se raportet dhe referencat e prezantuara (gjatë dhe pas ofertimit) nga ana e OE ankues “Rsm Company” Sh.p.k., janë raporte/referenca periodike që si të tilla nuk përcaktojnë përfundimin dhe pranimit teknik të punimeve ashtu siç kërkohet me raport/procesverbal të pranimit teknik të punëve të realizuara në bazë të nenit 32 dhe 33 të kontratës nr.44/2018 që i referohen dhe në pajtueshmëri me paragrafin 4.2 të nenit 69 të LPP-së

Paneli shqyrtues pas adminsitrimin të të gjitha provave përfshirë raportin e ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues “RSM Company” Sh.P.K., kërkesat dhe dëshmitë e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara sa i përket përfundimit të kësaj kontrate, megjithatë është gjetur se qëndron arsytimi i AK, për faktin se ankuesi me/apo pa fajin e tij ka dështuar të siguroj dëshmitë relevante në përputhje me nenin 69 të LPP-ës Kërkesë mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të DT 9.1 & 9.2 respektivisht dëshmit e kërkuara “certifikata /raport pranimi/ reference” kur shërbimi është bërë për një autoritet publik” po ashtu sipas gjykimit të këtij paneli OE, është dashur që para ofertimit të tij/saj në këtë aktivitet të kërkoj sqarime nga AK, lidhur me dokumentet të cilat i ka posur ne posedim për kontratën kontestuese të cilat nuk kanë qenë konform kërkesës së AK. Dhe po ashtu te gjitha referencat lidhur me kontrata e prezantuara ti paraqes në ofertëne tij/saj në kohën e ofertimit dhe jo pas dates së ofertimit ne kudneshtim me dispozitat e LPP-së.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues po ashtu pati parasysh që ky aktivitet është inicuar që nga viti 2022. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore.



- Përfundim -

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore dhe po ashtu mbanë dhe ka përgjegjësi sipas nenit 59.1 cituar “..Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës.” kurse sipas nenit 24, paragrafi 2” ...Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj...” pra duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së duke mos anashkaluar nenin 1 dhe 6 të LPP-ës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim. Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vjosa Gradinaj**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - RSM Company SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: